


UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

DEPARTAMENTI E DREJTA PENALE

NIVELI MASTER



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**POLITIKA NDËSHKIMORE NDAJ DHUNËS NË FAMILJE NË GJYKATËN
THEMELORE NË MITROVICË GJATË PERIUdhËS 2016 - 2021**

Mentorja:

Prof. Ass. Dr. Flutura Tahiraj

Kandidatja:

Bleona Musliu

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Një ndër problematikat me të cilën po përballlet Kosova tash e sa vite është numri i lartë i rasteve të dhunës në familje. Edhe përkundër faktit se institucionet në vend kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim siç është miratimi i Ligjit kundër dhunës në familje në vitin 2010 pastaj inkriminimi i dhunës në familje si vepër penale në Kodin Penal të vitit 2019, megjithatë ende mungojnë rezultatet konkrete në prandalimin dhe luftimin e kësaj forme të kriminalitetit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ka politika ndëshkimore në fushën e hetimit ndjekjes dhe shqiptimit të dënimeve.

Duke u nisur nga roli i politikës ndëshkimore në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, përmes këtij hulumtimi do të analizojmë legjislacionin përkitazi me dhunën në familje në Kosovë si dhe zbatimin e tij në fushën e politikës ndëshkimore të hetimit, ndjekjes dhe shqiptimit të dënimeve në regjionin e Mitrovicës. Përmes analizimit të bazës ligjore do të sqarojmë obligimet që dalin për policinë, prokurorinë dhe gjykatën në rajonin e Mitrovicës përkitazi me dhunën në familje ndërsa përmes analizimit të lëndëve penale do të prezantojmë përmbushjen e këtyre obligimeve nga ana e tyre.

Për të analizuar zbatimin e politikës ndëshkimore në fushat e përmendura më lartë, kemi shfrytëzuar statistikën e policisë, prokurorisë dhe gjykatës në Mitrovicë, ndërsa për analizimin e karakteristikave personale të kryesve si p.sh: gjinia, mosha, përkatësia etnike, statusi social dhe niveli arsimor kemi shfrytëzuar mostrën prej 50 lëndëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Këtë mostër e kemi përdorur edhe për analizimin e faktorëve me ndikim në kryerjen e dhunës në familje si dhe për analizimin e matjes së dënimit nga kjo gjykatë.

Fjalë kyçe: Dhuna, viktima, abuzuesi, keqtrajim, shkelje, mbrojtje, siguri